

**Salus Tirana Sh.a**

**Raporti i Audituesit të Pavarur  
dhe Pasqyrat Financiare më dhe për  
vitin e mbyllur 31 dhjetor 2016**

**Përmbajtja:**

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRA FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7 – 25



## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtuesve të Salus Tirana sh.a

### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Salus Tirana sh.a. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të shprehura në baza për kualifikimin e opinionit, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2016 si edhe të performancës së saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

### Baza për Kualifikimin e Opinionit

1. Siç paraqitet në shënimin 9, të pasqyrave financiare, Shoqëria ka kapitalizuar shpenzime të një natyre operacionale. Këto shpenzime, të cilat arrijnë vlerën 195,123 mijë Lek (31 dhjetor 2015:168,899 mijë Lek) janë njohur nga Shoqëria si "Shpenzime të shtyra". Ky trajtim nuk është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të cilat kërkojnë që këto shpenzime të rregjistrohen si shpenzime në periudhën që ndodhin. Rrjedhimisht, "Shpenzimet e shtyra" më 31 dhjetor 2016 janë mbivlerësuar me 195,123 mijë Lek (31 dhjetor 2015:168,899 mijë Lek), humbja për vitin është nënvlerësuar me 26,224 mijë Lek (31 dhjetor 2015: 15,125 mijë Lek) dhe humbja e akumuluar më 31 dhjetor 2016 është nënvlerësuar më 168,899 mijë Lek (31 dhjetor 2015: 153,774 mijë Lek).
2. Siç paraqitet në shënimin 4.4 të pasqyrave financiare, metoda e llogaritjes së amortizmit për qëllime të raportimit financiar është e ndryshme nga metoda e kërkuar nga ligjet tatimore të aplikueshme në Shqipëri. Referuar Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar këto diferenca janë diferenca të përkohshme të tatueshme dhe si të tilla shkaktajnë njohjen e detyrimeve tatimore të shtyra. Më dhe për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2016 Shoqëria nuk ka njohur shpenzime për tatime të shtyra dhe detyrime tatimore të shtyra, praktikë e cila nuk është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.
3. Siç paraqitet në shënimin 9, të pasqyrave financiare, Shoqëria ka gjeneruar humbje nga veprimtaria e saj dhe ka një humbje të akumuluar në masën 710,436 mijë Lek, ngjarje të cilat tregojnë që vlera e rikuperushme e aktiveve të saj mund të jetë më e vogël se vlera e tyre kontabël. Me 31 dhjetor 2016, Shoqëria nuk ka llogaritur vlerën e rikuperushme të këtyre aktiveve dhe humbjen e mundshme që mund të lindë, praktikë e cila nuk është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion ne nuk ishim në gjëndje të identifikonim nëse duhej rregjistruar ndonjë rregullim të këtyre aktiveve në pasqyrën e pozicionit dhe humbjes nga zhvlerësimi në pasqyrën fitimit ose humbjes dhe ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

### Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.



## **Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuadojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## **Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrollleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënime shpjeguese, si dhe nëse transaksionet dhe ngjarjet në pasqyrat financiare janë paraqitur në mënyrë të drejtë.

**Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)**

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Audit Albania sh.p.k*

Deloitte Audit Albania sh.p.k  
Rr. Elbasanit, Pallati poshte Fakultetit Gjeologji - Miniera,  
Tiranë, Shqipëri  
Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshem (NIPT): L41709002H



Auditues ligjor  
Nuriona Berdica Sokoli  
Tiranë, Shqipëri  
29 maj 2017



(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

<u>Aktivët</u>	Shënime	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
<b>I. Aktivët afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	5	4,173,607	4,653,247
Llogari të arkëtueshme	6	18,195,190	21,980,702
TVSH e arkëtueshme	7	2,518,603	1,940,070
Parapagim Tatim fitimi	7	127,000	127,000
Parapagime	7	1,152,040	980,985
Inventar	8	19,320,680	19,007,169
Shpenzime të shtyra	9	195,123,553	168,899,283
<b>Total i aktiveve afatshkurtra (I)</b>		<b>240,610,673</b>	<b>217,588,456</b>
<b>II. Aktivët afatgjata</b>			
Toka	10	122,566,950	122,566,950
Ndërtesa	10	1,132,055,323	1,157,057,001
Makineri dhe pajisje	10	307,926,901	322,536,478
Mjete transporti	10	3,543,974	4,506,597
Mobilje dhe orendi	10	37,585,170	44,762,023
Pajisje informatike	10	5,198,805	6,462,414
Të tjera aktive	10	3,295,703	3,810,075
Aktive afatgjata jo materiale	11	14,688,257	16,254,689
<b>Totali i aktiveve afatgjata (II)</b>		<b>1,626,861,083</b>	<b>1,677,956,227</b>
<b>Totali i aktiveve (I + II)</b>		<b>1,867,471,756</b>	<b>1,895,544,683</b>
<b>Detyrimet dhe kapitali</b>			
<b>I. Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme	12	169,356,465	154,358,503
Të pagueshme ndaj personelit	13	6,280,289	7,443,790
Detyrime tatimore	14	3,020,953	3,824,934
Hua afatshkurtra	15	60,589,229	27,721,980
Overdraft	15	99,602,203	103,239,812
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)</b>		<b>338,849,139</b>	<b>296,589,019</b>
<b>II. Detyrimet afatgjata</b>			
Hua bankare	16	391,491,989	455,503,625
Hua nga pale të lidhura	16	238,004,800	205,233,601
<b>Totali i detyrimeve afatgjata (II)</b>		<b>629,496,789</b>	<b>660,737,226</b>
<b>Totali i detyrimeve (I + II)</b>		<b>968,345,928</b>	<b>957,326,245</b>
<b>III. Kapitali</b>			
Kapitali aksioner	17	1,609,562,000	1,609,562,000
Humbje të mbartura	17	(671,343,561)	(572,301,220)
Humbje periudhe	17	(39,092,611)	(99,042,341)
<b>Totali i kapitalit (III)</b>		<b>899,125,828</b>	<b>938,218,438</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit (I, II, III)</b>		<b>1,867,471,756</b>	<b>1,895,544,683</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqët 7 deri në 25 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të shoqërisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2016 u aprovuan nga Këshilli Mbikqyrës në 29 maj 2017 dhe u nënshkruan:

Znj. Ilda Duhanshiu  
Eksperte kontabël



Z. Sidney Stock  
Përfaqësues ligjor

**SALUS** 04

# Salus Tirana Sh.A. NIPT.K82311006T

(Të gjitha shumat në Lek, përvecëse kur shprehet ndryshe)

Të ardhurat nga aktiviteti	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhurat nga shitjet	18	540,523,777	521,555,709
Të ardhura të tjera	18	3,038,944	3,625,683
		<b>543,562,721</b>	<b>525,181,392</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Kosto e materialeve dhe mallrave	19	(81,712,672)	(78,891,771)
Shpenzime personeli:	20		
-pagat e personelit	20	(95,620,289)	(114,743,735)
-kontributet për sigurimet shoqërore dhe shendetësore	20	(11,577,644)	(12,370,627)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	10	(73,686,937)	(73,278,293)
Humbje nga llogaritë e arkëtueshme	6	(3,380,750)	-
Shpenzime të tjera	21	(291,330,538)	(314,471,485)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(557,308,830)</b>	<b>(593,755,911)</b>
<b>Humbja nga veprimtaria kryesore</b>		<b>(13,746,109)</b>	<b>(68,574,518)</b>
Shpenzime për interesa	23	(35,224,642)	(47,283,412)
Fitimi nga kursi kembimi, neto	22	9,878,140	16,815,589
<b>Totali i shpenzimeve financiare, neto</b>		<b>(25,346,502)</b>	<b>(30,467,823)</b>
<b>Humbja para tatimit</b>		<b>(39,092,611)</b>	<b>(99,042,341)</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	24	-	-
<b>Humbje e periudhes</b>		<b>(39,092,611)</b>	<b>(99,042,341)</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>(39,092,611)</b>	<b>(99,042,341)</b>

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 deri ne 25 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**Salus Tirana Sh.a****Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Të gjitha shumat në Lek, përvecëse kur shprehet ndryshe)*

	<b>Kapitali aksioner</b>	<b>Humbje të mbartura</b>	<b>Totali</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2014</b>	1,609,562,000	(439,353,167)	1,170,208,831
Humbja e vitit	-	(132,948,053)	(132,948,053)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2014 (e rregulluar)</b>	<b>1,609,562,000</b>	<b>(572,301,220)</b>	<b>1,037,260,780</b>
Humbja e vitit	-	(99,042,341)	(99,042,341)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>1,609,562,000</b>	<b>(671,343,561)</b>	<b>938,218,439</b>
Humbja e vitit	-	(39,092,611)	(39,092,611)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>1,609,562,000</b>	<b>(710,436,172)</b>	<b>899,125,828</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet sëbashku me shënimet shpjeguese në faqët 7 deri në 25, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



(Të gjitha shumat në Lek, përvecëse kur shprehet ndryshe)

	Shënimi	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<b>I. Rrjedha monetar nga veprimtarite e shfrytëzimit</b>			
Humbja neto para tatimit	17	(39,092,611)	(99,042,341)
Rregullime për:			
Amortizimi	10	73,686,937	73,278,293
Provizione	6	3,380,750	-
Shpenzime për interesa		35,224,642	47,283,412
Humbje nga këmbimi të porealizuara		(3,095,374)	(16,815,588)
<b>Rrjedha operative para ndryshimeve në kapitalin punues</b>		<b>70,104,344</b>	<b>4,703,776</b>
Rritje(zvogëlim) në llogaritë e arketueshme		3,785,512	(5,571,340)
Zvogëlim ne llogarite e tjera të arketueshme		(26,973,859)	(15,373,594)
Rritje(zvogëlim) nga inventari		(313,511)	2,311,471
Rritje në llogari të pagueshme		14,997,961	3,826,506
Rritje në detyrime të tjera		(5,605,090)	(3,988,139)
<b>Rrjedha monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>(31,955,464)</b>	<b>(31,578,577)</b>
Interesi i paguar			
<b>Rrjedha neto monetar përdorur në veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>24,039,893</b>	<b>(45,669,897)</b>
<b>II. Rrjedha monetar nga veprimtaritë e investimit</b>			
Bjerje e aktiveve afatgjata materiale		(23,007,884)	(21,148,428)
Shitje aktiveve afatgjata materiale		499,147	-
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale		-	(630,552)
<b>Rrjedha neto monetar përdorur në veprimtaritë e investimit</b>		<b>(22,508,737)</b>	<b>(21,778,980)</b>
<b>III. Rrjedha monetar nga veprimtaritë e financimit</b>			
Zvogëlim nga huamarrje afatgjatë		(34,781,996)	(138,955,896)
Rritje nga huamarrje afatgjatë		32,771,200	203,163,955
<b>Rrjedha neto monetar nga veprimtaritë e financimit</b>		<b>(2,010,796)</b>	<b>64,208,059</b>
<b>IV. Pakësimi neto i mjeteve monetare</b>		<b>(479,640)</b>	<b>(3,240,817)</b>
<b>V. Mjetet monetare në fillim të periudhës</b>	<b>5</b>	<b>4,653,247</b>	<b>7,894,064</b>
<b>VI. Mjetet monetare në fund të periudhës</b>		<b>4,173,607</b>	<b>4,653,247</b>

Pasqyra e rrjedhjes së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqët 7 deri ne 25 që janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare.

(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

## 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Salus Tirana Sh.a (Shoqëria) është themeluar në 22 tetor 2008 në përputhje me ligjin numër 7638 datë 14.04.2008 “Mbi shoqëritë tregtare” me ligjin numër 9723 datë 3.5.2007 “Mbi Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” regjistruar me NUIS K82311006T.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është ofrimi shërbimeve jo publike mjekësore dhe spitalore.

Struktura e kapitalit të aksioneve të shoqërisë është si më poshtë:

- Anastas Pecini me 16.24%
- Olti Pecini me 23.76%
- Salus Holding me 34.77%
- Policlinico Triestino me 11.97%
- Finest me 9.77%
- Acane Investment Corporation 3.50%

Sipas kontratës së shitblerjes së aksioneve më 28 dhjetor 2015 Z.Sidney Stock, Z.Franco Stock kanë kryer shitjen e 3.5% të aksioneve të tyre që zotëronin në Salus Tirana sha tek Shoqëria Acane Investment Corporation, e cila tashmë zotëron 3.50% të aksioneve në Salus Tirana sha.

Anëtarë të Këshillit Drejtues të Shoqërisë janë Z. Guglielmo Danelon, Z. Franco Stock, Z.Olti Pecini dhe Z. Anastas Pecini regjistruar sipas certifikatës së Qendrës Kombëtare të Regjistrimit datë 20 janar 2012.

Përfaqësuesit Ligjore të Salus Tirana sh.a janë Z.Sidney Stock dhe Z. Rition Margariti.

Selia qendrore e Shoqërisë është në adresën Rruga Vidhe Gjata 16, Mezez-Kashar, Km 1, Autostrada TR-DR, Tiranë.

Shoqëria më 31 dhjetor 2016 ka 80 punonjës (2015: 78).

## 2. BAZA E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), mbi bazën e metodës së kostos historike.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur bazuar në parimin e vijimësisë, i cili supozon se Shoqëria do të vazhdojë të veprojë dhe në periudhat në vazhdim.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtuesit të bëjnë vlerësime dhe supozime. Bordi drejtues ushtron gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Elementët e pasqyrave financiare që kërkojnë një nivel më të lartë gjykimi ose subjektiviteti dhe për të cilat supozimet dhe gjykimet kanë influencë më të lartë janë shpjeguar në shënimin shpjegues 4.

(Të gjitha shumot në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 3. STANDARDET E REJA DHE INTERPRETIMET

#### 3.1. Standardet dhe interpretimet e reja ende të pa adaptuara

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standartet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtëme ishin publikuar, por akoma nuk ishin në fuqi:

- SNRF 9 "Instrumentat Financiare" dhe ndryshimet pasuese (efektiv për periudhën vjetore më ose pas 1 janar 2018),
- SNRF 14 "Rregullimi i Llogarive të shtyra" (efektive duke filluar nga 1 janar 2016 e në vazhdim)
- SNRF 15 "Te ardhura nga kontratat me klientët" (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2017),
- SNRF 16 "Qiratë" (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019).
- Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara" dhe SNK 28 "Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta"- Shitja apo kontributi i pasurive ndërmjet nje investitori dhe bashkëpunëtor të tij ose sipërmarrje të përbashkët (efektiv për një datë të shtyrë në një kohë të pacaktuar derisa projekti kërkimor në metodën e kapitalit është përfunduar),
- Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Rrjedhës së Parasë" - Nisma Për Paraqitje (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2017),
- Ndryshime në SNK 12 "Tatimet mbi të ardhurat", - Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për Humbjet e Parealizuar (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2017).
- Ndryshime në standartet e ndryshme "Përmirësimet e SNRF-ve (cikli 2014-2016)" Ndryshime që rezultojnë nga rishikimi vjetor që u është bërë SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12, dhe SNK 28), kryesisht me qëllim që të shmangen mosperputhjet dhe të qartësohet formulimi i standartit (Ndryshimet në SNRF 12 janë që do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017 dhe ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 janë të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018).
- KIRFN 22 "Transaksionet valutë dhe Konsiderata për avancat" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Shoqëria ka vendosur të mos i adaptojë këto standarte, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Shoqëria beson se adaptimi i standarteve të reja, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të shoqërisë në periudhën fillestare të aplikimit.



(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 3. STANDARDET E REJA DHE INTERPRETIMET (VAZHDIM)

#### 3.2 Standarte dhe interpretime efektive ne periudhen aktuale

Ndryshimet në standartet ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, dhe interpretimet e miratuara nga Komiteti Ndërkombëtarë i Interpretimeve të Raportimeve Financiare, janë efektive për periudhën aktuale:

- Ndryshime në SNRF 10 “Pasqyrat financiare të konsoliduara”, SNRF 12 “Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera” dhe 28 “Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta” – Subjektet e investimeve: Aplikimi I (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016).
- Ndryshimet në SNRF 11 “Marrëveshjet e përbashkëta” - Kontabiliteti për Blerjet e interesave në operacione të përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas dates 1 janar 2016).
- SNRF 14 “Regullatori per llogaritëre ne shtyrje” (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016)
- Ndryshime në SNK 1 “Paraqitja e pasqyrave financiare” – Iniciativat e zbulimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas dates 1 Janar 2016).
- Ndryshime në SNK 16 “Prona, Impiantet dhe Pajisjet” dhe SNK 38 “Aktive jo-materiale” - Sqarim i metodave të pranueshme të zhvleresimit dhe amortizimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas dates 1 Janar 2016),
- Ndryshime në SNK 16 “Prona, Impiantet dhe Pajisjet” dhe SNK 41 “Agrobiznesi” – Agrobiznes: Bimët bartësi (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas dates 1 Janar 2016)
- Ndryshime në SNK 27 “Pasqyrat financiare individuale” - Metoda e kapitalit në pasqyrat financiare individuale (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016)
- Ndryshime në disa standarde “Përmirësime të SNRF-ve (2012-2014)” që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19, SNK 34) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e fjalëve (ndryshimet duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016).

### 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL

#### 4.1. Paraqitja e pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### 4.2. Transaksionet në monedhë të huaj

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar (“Lek”), e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare të regjistruara në monedha të huaja në datën e raportimit, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të regjistruara në monedhë të huaj që matën me kosto të amortizuar, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur kryhet transaksioni. Diferencat që vijnë nga këmbimet valutore njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 4.3. Njohja e të ardhurave

##### I. Shitja e mallrave

Të ardhurat nga shitja e mallrave maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose për t'u arkëtuar dhe përfaqëson vlerën e arkëtueshme për të mirat dhe shërbimet të siguruara gjatë aktivitetit normal të biznesit, minus zbritjet dhe rabatet. Të ardhurat njihen kur ekziston dëshmi bindëse, përgjithësisht në formën e shërbimit ose të mirës së konfirmuar dhe të dorëzuar, nëse rreziqët dhe përfitimet e rëndësishme të pronësisë janë transferuar tek blerësi, mbledhja e tyre është e mundur; kostot e lidhura dhe kthimi i mundshëm i mallrave dhe shërbimeve mund të vlerësohet saktë; nuk ka përfshirje të vazhdueshme të drejtimit lidhur memallrat dhe shërbimet; dhe shumat e të ardhurave mund të matet saktë. Nëse është e mundur që zbritjet do të jepen dhe shuma mund të matet saktë, atëherë zbritja njihet si një pakësim i të ardhurave të shitjes gjatë procesit të njohjes së të ardhurave.

Koha e transferimit të rreziqëve dhe përfitimeve varet nga kushtet specifike të procesit të shitjes.

(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

#### 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.3. Njohja e të ardhurave (vazhdim)

###### II. Shërbimet

Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen në pasqyrën e të ardhurave në përpjestim me fazën e përfundimit të transaksionit në datën e raportimit.

###### III. Të ardhura nga interesi

Të ardhurat nga interesat përbëjnë interes për llogaritë e depozitave bankare dhe njihet në fitim ose humbje në baza kohore në proporcion duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### 4.4 Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale mbahen me kosto historike duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Kosto historike përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejtë me koston e blerjes së aktivit. Kostot e mëpasshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivit afatgjatë material ose njihen si aktiv më vete vetëm nëse është e mundshme që Shoqëria të ketë përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin në fjalë dhe kostoja e tij të mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjithë shpenzimet e tjera të mirëmbajtjeve dhe riparimeve njihen në fitim/humbje në momentin që ato ndodhin.

Amortizimi llogaritet në mënyrë lineare për të shpërndarë koston e aktiveve afatgjata materiale përgjatë jetës së tyre të dobishme. Amortizimi fillon të njihet në muajin pas atij të blerjes. Jetët e dobishme të zbatuara janë si në vijim

Përshkrimi i kategorisë	Metoda	Përqindje/Vit
Ndërtesa	Lineare	2%
Instalimet teknike, makineri dhe pajisje	Lineare	8%
Mjete transporti	Lineare	10%
Pajisje zyre dhe mobilje	Lineare	10%
Kompjutera dhe pajisje zyre	Lineare	25%
Aktive të tjera	Lineare	7.5%

Jeta e dobishme dhe vlera e mbetur e aktivit rishikohet dhe rregullohet, nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi. Vlera kontabël e një aktivit zvogëlohet menjëherë deri në vlerën e tij të rikuperueshme nëse vlera e mbetur e tij tejkalon këtë vlerë.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale njihen në zërin 'Të ardhura të tjera operacionale' në fitim ose humbje.

##### 4.5 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jo materiale të blera nga Shoqëria të cilat kanë jetëgjatësi të përcaktuara me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar në vlerë.

###### *Shpenzimet e mëpasshme*

Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm kur rrit përfitimet e ardhshme ekonomike këtij aktiviteti për të cilin ai lidhet. Të gjitha shpenzimet tjera, përfshirë shpenzimet për emrin e mirë të prodhuar vetë dhe të markave, njihet në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin. Shpenzimet lidhur me mbajtjen e programeve software kompjuteri njihen si shpenzime në momentin kur ndodhin.



(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

#### 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.5 Aktivet jo-materiale (vazhdim)

###### *Amortizimi*

Amortizimi llogaritet mbi bazë lineare përgjatë jetës së dobishme ekonomike të vlerësuar të aktiveve jo-materiale që prej datës se vënies në përdorim.

Kosto e programeve kompjuterike të njohura si aktiv amortizohen përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar e cila nuk është e madhe se katër vjet. Jeta e dobishme e aktivit rishikohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në fund të çdo viti financiar. Fitimet ose humbjet që rrjedhin nga çregjistrimi i një aktivi jo-material maten si diferencë midis të ardhurave neto nga nxjerrja jashtë përdorimi dhe vlera kontabël neto e aktivit dhe njihen në fitim ose humbje.

Për të vlerësuar demin shoqëria përcakton grupin më të vogël të identifikueshem të aktiveve që gjenerojnë flukse hyrese monetare (njësi gjeneruese e mjeteve monetare). Si rezultat, disa prej aktiveve testohen për zhvlerësimin në mënyrë individuale dhe të tjera si një pasuri që i përkasin njesisë gjeneruese të mjeteve monetare.

##### 4.6 Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata financiare

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse ka indikacion se një njësi gjeneruese të mjeteve monetare mund të jetë zhvlerësuar. Të gjitha aktivet e tjera janë testuar për zhvlerësim nëse ngjarjet apo rrethanat kanë ndodhur që tregojnë vlerën kontabël të aktiveve nuk mund të mbulohen.

Shoqëria njeh humbje nga zhvlerësimi, nëse vlera kontabël e një aktivi individual ose një njësi gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikupërueshme të aktivitetit, e cila është më e lartë e vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Për të përcaktuar vlerën në përdorim Shoqëria përgatit një vlerësim të flukseve monetare të ardhshme nga çdo njësi gjeneruese të mjeteve monetare dhe përdor një normë skontimi të përshtatshme për të llogaritur vlerën aktuale të këtyre flukseve të mjeteve monetare.

Të dhënat e përdorura në testet për zhvlerësim është i bazuar në buxhetin e aprovuar më të fundit të përshtatura për të eliminuar efektet e riorganizimit e ardhshme apo përmirësime të rëndësishme të aktiveve. Normat e skontimit janë të përcaktuara veçmas për çdo njësi gjeneruese të mjeteve monetare për të pasqyruar profilin e tyre specifike të rrezikut siç është vlerësuar nga ana e menaxhmentit të shoqërisë. Humbja nga zhvlerësimi i një njësie gjeneruese të mjeteve monetare është e njohur si një rënie e vlerës kontabël të të gjitha pasurive në njësi.

Për aktivet e gjithë Shoqërisë bëhet vlerësimi në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues të njohur më parë humbjet nga zhvlerësimi mund të ekzistojnë ose mund të jenë zvogëluar. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur më parë rimerret plotësisht ose pjesërisht, vetëm nëse shumat e rikupërueshme e njesisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e tij kontabël, e cila ndryshim është i kufizuar në shumën e humbjeve nga zhvlerësimi që janë njohur në fitim ose humbje për të njëjtën të mjeteve monetare njësi gjeneruese. Një aktiv financiar vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive për zhvlerësimin e tij. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

##### 4.7 Qiratë

Pagesat e bëra për qira operative njihen në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qirasë. Stimujt e marrë për qiranë njihen si pjesë integrale e pagesës totale të qirasë përgjatë kohëzgjatjes së saj.

##### 4.8 Inventarët

Inventarët maten me më të ultën midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Kosto e inventarëve llogaritet me metodën e koston mesatare, dhe përfshin të gjithë shpenzimet e ndodhura gjatë blerjes dhe kostot e tjera që nevojiten për ta sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese duke përfshirë koston e banderolave të blera nga Dogana Shqiptare në lidhje me akcizen e produktit.



(Të gjitha shumot në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

#### 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.9 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare tyre përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse në banka dhe depozitat afatshkurtra të mbajtura në banka. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### 4.10 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë e Shoqërise gjatë vitit 2016 përbëheshin ekskluzivisht nga instrumente jo-derivative financiare: huatë dhe të arkëtueshmet (tregtare dhe të tjera), mjete monetare dhe ekuivalentët e dhe të tjera të pagueshme. Instrumentat financiar mbahen në vlerën e drejtë ose me koston e amortizuar të përshkruar më poshtë, në varësi të klasifikimit të tyre.

##### *Njohja*

Shoqëria fillimisht njih kreditë dhe depozitat në datën kur lindin të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Të gjitha detyrimet dhe aktivet financiare njihen në datën e transaksionit sipas së cilit Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktore të instrumentit.

##### *Matja e mëpasshme*

##### *Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre*

Mjetet monetare tyre përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse në banka dhe depozitat afatshkurtra të mbajtura në banka. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Huadhenia dhe llogarite e arketueshme (Llogarite e arketueshme tregtare dhe të tjera)*

Huadheniet dhe llogarite e arketueshme maten me koston e amortizimit të tyre me pak se çdo humbje nga dëmi. Llogaritë e arketueshme me një kohëzgjatje të shkurtër nuk zbriten.

##### *Huatë dhe llogari të tjera të pagueshme*

Llogari të tjera të pagueshme maten më pas me koston e amortizuar.

##### *(I) Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyre individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### *(II) Çrregjistrimi*

Aktivët financiarë nuk njihen nëse të drejtat kontraktuale të shoqërisë nga rrjedhjet e parase nga aktivet financiare u mbaron afati ose Shoqëria transferon aktivet financiare në një pjesë tjetër pa rimarrë kontrollin ose thelbin e të gjitha risqëve dhe shpërblimeve të aktiveve. Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuar në kontratë u mbaron afati, shlyhen ose anulohen.

(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

#### 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.10 Instrumentat financiarë (vazhdim)

###### *(III) Kompensimi i instrumentave financiare*

Aktivët financiarë dhe detyrimet financiarë janë kompensuar në shumën neto të raportuara në pasqyrën e pozicionit financiar dhe vetëm nëse është aktualisht e drejta ligjore e detyrueshme për kompensimin e shumave të njohura dhe nëse nuk ka qëllim për të vendosur në bazë neto ose për të realizuar aktivet dhe shlyer detyrimin njëherësh.

###### *(IV) Vlera e drejtë*

Vlera e drejtë e parase dhe ekuivalenteve të saj, llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera, llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera janë përafërsisht të barabarta me vlerën e mbartur për shkak të maturisë së tyre afatshkurtër.

##### 4.11 Skema me kontribute të përcaktuara

Një skemë me kontribute të përcaktuara është një skemë përfitimi pas punësimit në të cilën një shoqëri paguan kontribute fikse në një njësi të veçantë pa asnjë detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar shumën e tjera shtesë. Detyrimet për kontribute në skemat e pensioneve me kontribute të përcaktuara, si fondi i pensionit të shtetit shqiptar, njihen në fitim ose humbje kur ka lindur detyrimi për t'i paguar.

##### 4.12 Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punonjësve vlerësohen të paskontuara dhe njihen si shpenzim kur shërbimi përkatës kryhet. Një detyrim do të njihet për shumën që pritet të paguhet nga përfitimet afatshkurtra nëse Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara të siguruar nga punonjësi dhe detyrimi mund të vlerësohet me besueshmëri.

##### 4.13 Përfitimet e punonjësve

Në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës, subjektet shqiptare janë të detyruar të paguajnë kontributet mujore për përfitime të daljes në pension të parashikuara për punonjësit e tyre nga të administruar planit të definuar të shtetit të kontributit. Shoqëria nuk ka detyrime shtesë mbi punonjësit duke e lënë të shoqërisë ose të drejtë për kontributin pensional.

##### 4.14 Tatim fitimi

###### Tatim fitim i parapaguar

Aktivët e tatim fitimit të parapaguar dhe detyrimet për periudhat aktuale dhe paraprake maten me shumën që pritet të mbulohet ose paguhet në organet tatimore. Norma e taksës dhe ligjet e taksës që llogarisin shumën janë ato që janë miratuar në datën e raportuar.

###### Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e detyrimeve, duke siguruar për diferenca të përkohëshme midis shumave mbajtëse të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumave të përdorura për qëllime taksimi. Tatimi i shtyrë matet në normat e taksave që pritet të aplikohen në diferencat e përkohëshme kur ato ndryshojnë, bazuar në ligjet që janë miratuar. Aktivët e shpenzimeve të shtyra dhe detyrimet kompensohen nëse ka një të drejtë ligjore për kompensimin e taksave aktuale të aktiveve dhe detyrimeve dhe ato lidhen me tatim fitimin e parapaguar duke mbledhur taksat nga i njëjti autoritet.

###### Tatim mbi vlerën e shtuar

Të ardhurat, shpenzimet dhe aktivët njihen si shumë neto e TVSH-së përveç:

-Kur TVSH-ja ka ardhur nga një blerje aktivesh ose shërbimesh dhe nuk është e kreditueshme nga legjislacioni fiskal, TVSH-ja njihet si pjesë e kostos së blerjes së aktivitetit ose si pjesë e shpenzimit të llogarisë përkatëse.

-Llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme që janë deklaruar me shumën e TVSH-së përfshirë



(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

#### 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

##### 4.15 Provigjonet, detyrimet dhe aktivet

Nje provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet me besueshmeri, dhe ka mundësi që flukse dalese të përfitimeve ekonomike do të jete te nevojshme për të shlyer detyrimin.

Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të parasë me një normë para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të detyrimit.

##### 4.16 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në ndonjë periudhë të ardhshme që mund të preket.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga shoqëria.

##### Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur duke u mbështetur në parimin e vijueshmërisë, i cili presupozon që shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e tij operacionale për të ardhmen e parashikueshme. Ne baze te planit financiar te aprovuar për shoqërine ne vitet e ardhshme Shoqëria parashikon te rrise aktivitetin e saj operacional dhe parashikohet që ne vitin e ardhshem te jete me rezultat pozitiv. Përveç sa me sipër aksionaret e shoqërise kane marre angazhim që do te mbeshtesin shoqerine me financime, ne rast se kjo do te jete e nevojshme.

##### Tatimi i shtyrë

Njohja e tatimit të shtyrë përfaqëson taksat e ardhura të kthyeshme nëpërmjet deduksioneve të ardhme nga përfitimet e taksave dhe regjistrohet në pasqyrën financiare. Tatimi mbi te ardhurat e shtyra regjistrohet deri në masën që realizimi i benefiteve të taksave është i mundur. Përfitimet e ardhshme të taksave dhe shumave e benefiteve të taksave që janë të mundshme në të ardhmen bazohet në planin afat mesëm të biznesit të përgatitur nga manaxhimi dhe rishikimi i rezultateve të mëtejshme. Plani i biznesit është i bazuar në pritshmëritë menaxheriale që besohet se janë të arsyeshme sipas rrethanave.

##### Kontratat e qirasë

Nje qira financiare është nje qira që transferon thelbësisht të gjitha risqët dhe shpërblimet e rastit për zotërimin e një aktivi. Titulli/cmri mund ose nuk mund të transferohet. Gjykimet manaxheriale kërkojnë të përcaktojnë nëse ka prova që risqët dhe shpërblimet e rastësishme të transferohen qoftë edhe një transaksion financiar ose një qira e zakonshme.

##### 4.17 Informacion krahasues

Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria ka llogaritur vlerën e drejtë të kredisë dhënë nga palët e lidhura me interes 1.5% - detajuar në shënimin 15 në bazë të SNK 39 Instrumentet financiare: Njohja dhe matja ".

Për këtë arsye diferenca me parapagimet e kompanisë dhe vlerës së drejtë të kredisë është e njohur si një shpërndarje ne Shoqeri.

Shoqeria ka riklasifikuar nga "Hua nga palët e lidhura" - Shënimi 16 në "Rezervën Kredie me vlere te drejte" në shënimin 17 shuma prej 27,640,836 lekë kanë të bëjnë me rregullimin e vlerës së drejtë ne 31 dhjetor 2015.



(Të gjitha shumat në Lek, përvecëse kur shprehet ndryshe)

## 5. MJETE MONETARE

Mjetet monetare të klasifikuara sipas monedhës më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë si mëposhtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
<i>Në Bankë</i>		
në lekë	2,864,893	2,529,467
në euro	40,689	389,391
<i>Arka</i>		
në lekë	139,044	47,547
në euro	1,128,981	1,686,842
<b>Totali</b>	<b>4,173,607</b>	<b>4,653,247</b>

## 6. LLOGARITË TE ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme deri më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë si mëposhtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Llogari të arkëtueshme nga individ	12,426,565	11,503,423
Llogari të arkëtueshme nga shoqëri	9,149,375	10,477,279
Provigjon per renie ne vlere	(3,380,750)	-
<b>Totali</b>	<b>18,195,190</b>	<b>21,980,702</b>

## 7. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

Kërkesa të tjera për t'u arkëtuar më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë si mëposhtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Tvsh kreditore	2,518,603	1,940,070
Paradhënie	1,152,040	980,985
Tatimi mbi fitimin	127,000	127,000
<b>Totali</b>	<b>3,797,643</b>	<b>3,048,055</b>

(Të gjitha shumot në Lek, përvecëse kur shprehet ndryshe)

## 8. INVENTARI

Inventari në 31 dhjetor 2016 dhe 2015 jepet si mëposhtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Inventari	<u>19,320,680</u>	<u>19,007,169</u>
<b>Shuma</b>	<b><u>19,320,680</u></b>	<b><u>19,007,169</u></b>

Gjendjet inventariale përmban medikamente dhe materiale të tjera që përdoren gjatë aktivitetit normal të spitalit.

## 9. SHPENZIME TË SHTYRA

Shpenzime të shtyra deri në 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë si mëposhtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Shpenzime të shtyra	<u>195,123,553</u>	<u>168,899,283</u>
<b>Totali</b>	<b><u>195,123,553</u></b>	<b><u>168,899,283</u></b>

Shpenzimet e shtyra përfshijnë kostot e fillimit në fazën fillestare, në mënyrë që të sjellin në kushte operacionale spitalin. Shoqëria ka kapitalizuar shpenzime operacionale rreth 26 milion Lek gjatë vitit 2016 (2015: 15 milion Lek).

(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

**10. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen si mëposhtë:

	Toka	Ndërtesa	Instalime teknike dhe pajisje vegla pune	Mjete transporti	Kompjutera dhe pajisje informatike	Mobilje zyrash	Të tjera	Totali
<b>Më 31 dhjetor 2014</b>	<b>122,531,950</b>	<b>1,249,774,675</b>	<b>428,842,711</b>	<b>6,274,363</b>	<b>14,089,469</b>	<b>74,060,324</b>	<b>5,567,644</b>	<b>1,901,141,136</b>
Shitesa	35,000	310,300	14,004,964	352,825	6,182,002	159,133	104,204	21,148,428
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>122,566,950</b>	<b>1,250,084,975</b>	<b>442,847,675</b>	<b>6,627,188</b>	<b>20,271,471</b>	<b>74,219,457</b>	<b>5,671,848</b>	<b>1,922,289,564</b>
Shitesa	-	-	21,831,382	-	855,432	262,390	58,680	23,007,884
Pakesime	-	-	(146,321)	(352,825)	-	-	-	(499,146)
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>122,566,950</b>	<b>1,250,084,975</b>	<b>464,532,736</b>	<b>6,274,363</b>	<b>21,126,903</b>	<b>74,481,847</b>	<b>5,730,528</b>	<b>1,944,798,302</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>								
<b>Më 31 dhjetor 2014</b>	<b>-</b>	<b>(68,026,275)</b>	<b>(86,329,960)</b>	<b>(1,475,513)</b>	<b>(9,688,296)</b>	<b>(22,050,075)</b>	<b>(1,296,156)</b>	<b>(188,866,275)</b>
Shpenzimi i amortizimit për vitin	-	(25,001,699)	(33,981,237)	(645,078)	(4,120,761)	(7,407,358)	(565,617)	(71,721,751)
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>-</b>	<b>(93,027,974)</b>	<b>(120,311,197)</b>	<b>(2,120,591)</b>	<b>(13,809,057)</b>	<b>(29,457,434)</b>	<b>(1,861,773)</b>	<b>(260,588,026)</b>
Shpenzimi i amortizimit për vitin	-	(25,001,678)	(36,348,290)	(639,199)	(2,119,041)	(7,439,243)	(573,052)	(72,120,503)
Pakesime	-	-	53,651	29,402	-	-	-	83,052
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>-</b>	<b>(118,029,652)</b>	<b>(156,605,836)</b>	<b>(2,730,388)</b>	<b>(15,928,098)</b>	<b>(36,896,676)</b>	<b>(2,434,825)</b>	<b>(332,625,477)</b>
<b>Vlera Kontabel Neto</b>								
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>122,566,950</b>	<b>1,157,057,001</b>	<b>322,536,479</b>	<b>4,506,597</b>	<b>6,462,414</b>	<b>44,762,023</b>	<b>3,810,075</b>	<b>1,661,701,541</b>
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>122,566,950</b>	<b>1,132,055,323</b>	<b>307,926,901</b>	<b>3,543,974</b>	<b>5,198,805</b>	<b>37,585,170</b>	<b>3,295,703</b>	<b>1,612,172,826</b>



(Të gjitha shumot në Lek, përvecëse kur shprehet ndryshe)

**11. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE**

	Konçensione dhe liçensa	Software	Të tjera aktive	Totali
<b>Kosto</b>				
Më 31 dhjetor 2015	1,153,518	18,566,868	1,417,728	21,138,114
Shtesa	-	-	-	-
Me 31 dhjetor 2016	1,153,518	18,566,868	1,417,728	21,138,114
<b>Amortizimi i akumuluar</b>				
Më 31 dhjetor 2015	(143,634)	(4,403,076)	(336,713)	(4,883,423)
Amortizimi i vitit	(86,514)	(1,373,591)	(106,329)	(1,566,434)
Më 31 dhjetor 2016	(230,148)	(5,776,667)	(443,042)	(6,449,857)
<b>Vlera Kontabël Neto</b>				
Më 31 dhjetor 2015	1,009,884	14,163,792	1,081,013	16,254,689
Më 31 dhjetor 2016	923,370	12,790,201	974,686	14,688,257

**12. LLOGARI TË PAGUESHME**

Llogaritë e pagueshme në 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë si mëposhtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Detyrime ndaj furnitorëve në monedhë të huaj	92,771,268	64,271,800
Detyrime ndaj furnitorëve në monedhë lokale	71,006,239	82,094,369
Shpenzime të llogaritura	5,578,958	7,992,335
<b>Totali</b>	<b>169,356,465</b>	<b>154,358,504</b>

**13. TË PAGUESHME NDAJ PERSONELIT**

Llogaritë e pagueshme ndaj personelit në 31 dhjetor, 2016 dhe 2015 janë si mëposhtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Paga dhe shpërblime	6,280,289	7,443,790
<b>Totali</b>	<b>6,280,289</b>	<b>7,443,790</b>

**14. DETYRIME TATIMORE**

Detyrimet tatimore në 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë si mëposhtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	1,627,090	1,670,936
Tatim mbi të ardhurat personale	862,191	1,101,334
Tatim në burim	531,672	1,052,664
<b>Totali</b>	<b>3,020,953</b>	<b>3,824,934</b>

(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

**15. HUA AFASHKURTRA**

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
*Intesa San paolo(overdraft)	65,670,992	66,833,302
Veneto Bank	60,589,229	27,721,980
**Veneto Bank(overdraft)	33,931,211	36,406,510
<b>Totali</b>	<b>160,191,432</b>	<b>130,961,792</b>

\*Kjo hua me Intesa San Paolo ka një normë interesi vjetore EUR/BOR 6M 4%+5%

\*\*Kjo hua me Veneto Banka ka një normë interesi vjetore EUR/BOR 3M 2.75%+1.75%.

**16. HUA AFATGJATA**

Huaja afatgjate në 31 dhjetor, 2016 dhe 2015 janë si mëposhtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Veneto Bank	391,491,989	455,503,625
Policlinico	238,004,800	205,233,600
<b>Totali</b>	<b>629,496,789</b>	<b>660,737,225</b>

**17. KAPITALI AKSIONER**

Më 31 dhjetor 2016, kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 11,700,000 aksione me vlerë nominale 1 Eur (2015:11,700,000, aksione me vlerë nominale prej 1 Eur).

Aksionerët	Numri i kuotave 2016	Kuotat në %	Numri i kuotave 2015	Kuotat në %
Olti Peçini	2,780,000	23.76%	2,780,000	23.76%
Salus Holding	4,067,779	34.77%	4,067,779	34.77%
Anastas Peçini	1,900,000	16.24%	1,900,000	16.24%
Policlinico Triestino	1,400,000	11.97%	1,400,000	11.97%
Finest	1,142,721	9.77%	1,142,721	9.77%
Acane Investment Corporation	409,500	3.50%	-	-
Franco Stock	-	-	204,750	1.75%
Sidney Stock	-	-	204,750	1.75%
<b>Totali</b>	<b>11,700,000</b>	<b>100%</b>	<b>11,700,000</b>	<b>100%</b>

  

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Kapitali aksioner	1,609,562,000	1,609,562,000
Humbje të mbartura	(671,343,561)	(572,301,222)
Humbje të periudhës	(39,092,611)	(99,042,341)
<b>Totali</b>	<b>899,125,828</b>	<b>938,218,437</b>

(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

**18. TE ARDHURA NGA SHITJET**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shitje e punimeve dhe e shërbimeve	538,621,238	519,364,974
Të tjera të ardhurave	3,038,944	3,625,683
Qera	1,902,539	2,190,735
<b>Totali</b>	<b>543,562,721</b>	<b>525,181,392</b>

**19. KOSTO E MATERIALEVE DHE MALLRAVE**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Blerja e materialeve ndihmëse	60,627,940	59,881,310
Blerja e materialeve te para	17,983,647	17,046,155
Të tjera materiale	1,737,091	1,021,048
Blerja e materialeve të pastrimit dhe higjienës	1,363,994	943,258
<b>Totali</b>	<b>81,712,672</b>	<b>78,891,771</b>

**20. SHPENZIME PERSONELI**

Shpenzime personeli përbëhet nga pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime personeli		
Paga	95,620,289	114,743,735
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	11,577,644	12,370,627
<b>Totali</b>	<b>107,197,933</b>	<b>127,114,362</b>

Shpenzim personeli lidhet me shpenzimet për tu paguar për pagat e muajit dhjetor 2016.



(Të gjitha shumot në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

**21. SHPENZIME TE TJERA**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime konsulence	176,430,658	162,340,155
Shpenzime mjekësore	22,612,965	32,452,116
Shpenzime energjie	20,100,246	28,193,400
Shpenzime personalë	19,069,886	10,464,832
Shpenzime publiciteti	11,091,595	8,979,046
Shpenzime mirëmbajtje	4,205,725	4,116,001
Shërbime të tjera	15,796,347	3,523,344
Shpenzime të tjera	22,023,116	64,402,591
<b>Totali</b>	<b>291,330,538</b>	<b>314,471,485</b>

**22. FITIMI NGA KURSI I KEMBIMIT, NETO**

Fitimet dhe humbjet nga kursi i kembimit janë detajuar si mëposhte:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Fitime nga shkëmbimet valutore	13,900,598	20,872,924
Humbje nga shkëmbimet valutore	(4,022,458)	(4,057,335)
<b>Totali</b>	<b>9,878,140</b>	<b>16,815,589</b>

**23. SHPENZIME NGA INTERESA**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime nga interesa	(35,224,642)	(47,283,412)
<b>Totali</b>	<b>(35,224,642)</b>	<b>(47,283,412)</b>

(Të gjitha shumat në Lek, përvecëse kur shprehet ndryshe)

**24. SHPENZIM TATIM FITIMI**

Tatim fitimi përbëhet nga tatim fitimi i Shoqërisë për vitin financiar 2016. Në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar norma e aplikueshme e tatim fitimit për 2016 është 15% (2015: 15%).

	<b>2016</b>	<b>2015</b>
<b>Humbja kontabël</b>	<b>(39,092,611)</b>	<b>(99,042,341)</b>
<b>Shpenzime të panjohura sipas ligjit fiskal</b>		
Karburant	115,840	185,100
Mirëmbajtje dhe riparime	68,250	184,519
Qera personeli	3,612,166	7,932,105
Shpenzime pritje e përfaqësime	1,411,059	77,996
Gjoha dhe demshpërblime	322,086	481,328
Amortizimi	36,441,070	20,158,567
Provizionim klientësh	3,380,750	-
Shpenzime të tjera	32,724,547	10,948,487
<b>Shpenzime të panjohura</b>	<b>78,075,768</b>	<b>39,968,462</b>
Fitim/ (Humbja) fiskale	38,983,157	(59,073,878)
<b>Humbja fiskale e mbartuar nga 2015 / (2014)</b>	<b>(177,969,139)</b>	<b>(348,338,961)</b>
<b>Humbje fiskale për tu mbartur me 2016 / (2015)</b>	<b>(138,985,982)</b>	<b>(407,412,840)</b>

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi janë parashikime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore .

(Të gjitha shumot në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

**25. PALET E LIDHURA**

Në rrjedhën e kryerjes së veprimtarisë operacionale të saj, Shoqëria ka hyrë në transaksione biznesi të ndryshme me palët e saj të lidhura. Palët e lidhura me të cilat Shoqëria ka patur transaksione përfshijnë Anastas Pecini, PoliclinicoTriestino dhe Salus Holding. Për periudhën që përfundon në 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015, kanë ndodhur transaksionet me palët e lidhura të mëposhteme:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
<b>Gjendje e detyrimeve me pale te lidhura</b>		
Policlinico Triestino	66,362,002	41,519,871
<b>Totali</b>	<b>66,362,002</b>	<b>41,519,871</b>
<b>Hua me pale te lidhura</b>		
Policlinico	238,004,800	205,233,601
<b>Totali</b>	<b>238,004,800</b>	<b>205,233,601</b>
<b>Transaksione me pale te lidhura për tarife menaxhimi dhe shpenzime te tjera</b>		
Policlinico Triestino	22,069,419	27,383,767
Te tjera shpenzime	12,681,822	10,140,061
<b>Totali</b>	<b>34,751,241</b>	<b>37,523,828</b>
<b>Përfitimet afatshkurtra</b>		
Paga ndaj menaxhimit	1,200,000	1,223,692
<b>Totali</b>	<b>1,200,000</b>	<b>1,223,692</b>

**26. ANGAZHIME DHE PASIGURI**

Gjate aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime ligjore nga dhe me palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekt në pozicionin financiar të Shoqërisë ose nuk do të sjellë ndryshime në aktive.

**27. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR**

Menaxhimi i rrezikut është një element thelbësor në aktivitetet e Shoqërisë. Rreziqet më të mëdha që ka Shoqëria janë ato të lidhura me rrezikun e tregut, (që përfshijnë çmimin, normën e interesit dhe rrezikun e monedhës), rrezikun e kreditit dhe rrezikun e likuiditetit.

*(i) Rreziku i kursit të këmbimit*

Shoqëria zotëron aktive dhe detyrime në monedhën Euro. Rreziku i kursit të këmbimit është i pranishëm kur aktivet aktuale ose të parashikuara në monedhë të huaj janë më shumë ose më pak se detyrimet në atë monedhë. Impakti i rrezikut të kursit të këmbimit të Shoqërisë është e kufizuar duke qënë se transaksionet janë të kufizuar në monedhat lekë dhe Euro.



(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

**28. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

(i) *Rreziku i kursit të këmbimit*

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 ishte si mëposhtë:

Më 31 dhjetor 2016	Vlera Kontabël	Euro	Lek
Llogari të arkëtueshme	18,195,190	15,852,770	2,342,420
Të tjera aktive	3,797,644	318,188	3,479,456
Mjete monetare	4,173,607	1,169,671	3,003,936
Llogari të pagueshme	169,356,465	92,771,268	76,585,197
Të tjera detyrime	9,301,242	-	9,301,242
<b>Totali</b>	<b>204,824,148</b>	<b>110,111,897</b>	<b>94,712,251</b>

Më 31 dhjetor 2015	Vlera Kontabël	Euro	Lek
Llogari të arkëtueshme	20,272,594	18,182,265	2,090,329
Të tjera aktive	980,985	274,535	706,450
Mjete monetare	4,653,247	2,076,232	2,577,015
Llogari të pagueshme	151,567,006	61,480,302	90,086,703
Të tjera detyrime	11,198,833	-	11,198,833
<b>Totali</b>	<b>188,672,665</b>	<b>82,013,334</b>	<b>106,659,330</b>

	Kursi këmbimi mesatar		Kursi këmbimi në datën e raportimit	
	2016	2015	2016	2015
EUR	137.36	139.74	135.23	137.28
USD	113.77	125.96	128.17	125.79

*Analiza e ndjeshmërisë ndaj kurseve të këmbimit*

Analiza e mëposhtme e ndjeshmërisë është përcaktuar bazuar në ekspozimin e monedhës së huaj në datën e raportimit dhe në ndryshimet e llogaritura në fillim të vitit fiskal dhe të mbajtura konstante gjatë gjithë periudhës raportuese. Më poshtë jepet një përcaktim i efektit të ndryshimeve të kurseve të këmbimit në fitimin neto, duke i konsideruar të gjithë variablat e tjerë të mbajtur konstant.

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Euro vlerësohet me 10 %	106,000	8,201
Euro zhvlerësohet me 10 %	(106,000)	(8,201)

(ii) *Rreziku i normës së interesit*

Të ardhura të Shoqërisë dhe flukset e mjeteve monetare janë kryesisht të pavarura nga ndryshimet në normat e interesit të tregut. Shoqëria nuk ka asete të rëndësishme me interes.

(Të gjitha shumot në Lek, përvecëse kur shprehet ndryshe)

**27. MANAXHIMI RREZIKUT FINANCIAR****(iii) Rreziku nga taksat**

Legjislacioni tatimor shqiptar është subjekt i interpretimeve të ndryshme dhe ndryshime që ndodhin shpesh. Si rezultat, transaksionet mund të kundërshtohen nga autoritetet tatimore dhe shoqërisë mund të vlerësohen taksat shtesë, gjopa dhe kamata, të cilat mund të jenë të rëndësishme. Periudha mbetet e hapur për të shqyrtuar nga tatimi dhe autoriteteve doganore në lidhje me detyrimet tatimore për pesë vjet. Menaxhmenti i Shoqërisë nuk është në dijeni të çdo rrethane, e cila mund të shkaktojë një detyrim material të mundshëm në këtë drejtim.

**(iv) Rreziku i likuiditetit**

Më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 struktura e maturimit të detyrimeve financiare të Shoqërisë në bazë të pagesave të kontraktuara paskontuar është paraqitur më poshtë:

**Administrimi i rrezikut financiar**

<b>Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016 (mijë lek)</b>	<i>Me pak se 3 muaj</i>	<i>3-12 muaj</i>	<i>1-5 vite</i>	<b><i>Totali</i></b>
Interesat e kredive( Shënimi 15)	-	60,589	391,492	<b>452,081</b>
Llogari të pagueshme tregtare e të tjera (Shënimi 12)	-	165,316	-	<b>165,316</b>
<b>Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2015 (mijë lek)</b>	<i>Me pak se 3 muaj</i>	<i>3-12 muaj</i>	<i>1-5 vite</i>	<b><i>Totali</i></b>
Interesat e kredive( Shënimi 15)	-	27,722	664,064	<b>692,326</b>
Llogari të pagueshme tregtare e të tjera (Shënimi 12)	-	151,567	-	<b>151,567</b>

**28. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT**

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.